



Shqipëria përballë Erës së Re të rrezikut gjeopolitik dhe tregtar të Bashkimit Evropian

Analizë mbi proceset, sfidat dhe tendencat kryesore ekonomike dhe fiskale brenda kësaj perspektive kohore deri në hyrjen në BE

Shqipëria përballë erës së re të rrezikut gjeopolitik dhe tregtar të Bashkimit Evropian



ALTAX – QENDRA SHQIPTARE PËR POLITIKA EKONOMIKE DHE FISKALE

Platforma për Transparencë, Financë Publike dhe Politika Fiskale

 www.altax.al |  info@altax.al

Dokument Politikash | Nr. 2025/11/23

Shqipëria përballë erës së re të rrezikut gjeopolitik dhe tregtar të BE

Analizë mbi proceset, sfidat dhe tendencat kryesore brenda kësaj perspektive kohore

Përgatitur dhe publikuar nga ALTAX

 **Nëntor 2025**

ALTAX - ALBANIAN CENTER FOR ECONOMIC AND FISCAL POLICY STUDIES

Platform for Transparency, Public Finance and Fiscal Policy

 www.altax.al |  info@altax.al

Working Paper | No. 2025/11/23

Albania faces the new era of EU geopolitical and trade risk

Analysis of the main processes, challenges and trends within this time perspective

Prepared and published by ALTAX

 **November 2025**

ALTAX – Qendra Shqiptare për Politika Ekonomike dhe Fiskale

Një qendër kërkimore dhe zhvillimore për një të ardhme më transparente dhe të qëndrueshme ekonomike

Rreth ALTAX

ALTAX është një organizatë jofitimprurëse me bazë në Shqipëri, që funksionon si qendër studimore e pavarur për politika ekonomike dhe fiskale. Misioni i saj është të ofrojë analizë të thelluar, të paanshme dhe të besueshme mbi zhvillimet ekonomike dhe fiskale në Shqipëri, duke vlerësuar ndikimet që burojnë nga faktorë politikë, kulturorë, ideologjikë, ekonomikë dhe historikë.

Synimi i ALTAX është të kontribuojë në formulimin e politikave efektive që shërbejnë jo vetëm për Shqipërinë, por edhe për rajonin më të gjerë të Ballkanit Perëndimor.

Fokusi dhe Veprimtaria

ALTAX bashkëpunon me akademikë, ekspertë fiskalë dhe organizata ndërkombëtare, me qëllim rritjen e kapaciteteve analitike dhe të politikëbërjes në Shqipëri dhe Kosovë.

Përmes analizave të detajuara mbi ekonominë, sistemin tatimor dhe indikatorët makro/mikroekonomikë, ALTAX mbështet transparencën, llogaridhënien dhe përmirësimin e vendimmarrjes publike.

Fushat e Angazhimit

- Studimi i tregjeve dhe tendencave sektoriale
- Analiza e buxhetit të shtetit dhe e të dhënave statistikore
- Hartimi i raporteve mbi politikat ekonomike dhe fiskale
- Parashikimi i zhvillimeve të ardhshme për donatorë dhe palë të interesuara
- Vlerësimi i ndikimit të politikave fiskale dhe monetare në shoqëri dhe ekonomi

Shërbimet e ALTAX

- Përgatitja e analizave mbi politikat ekonomike dhe fiskale
- Hartimi i modeleve të politikave publike dhe ekspertizave sektoriale
- Realizimi i studimeve dhe raporteve në bashkëpunim me partnerë kombëtarë dhe ndërkombëtarë
- Vlerësimi i trendeve të tregut dhe faktorëve ndikues
- Përpunimi i të dhënave për ndikim në formulimin e politikave

Kontakti

 Për më shumë informacion mbi analizat dhe shërbimet që ofron ALTAX, vizitoni platformën zyrtare ose kontaktoni direkt qendrën. Ekipi i ALTAX është i gatshëm të ofrojë zgjidhje të personalizuar për pyetje ose kërkesa specifike.

 www.altax.al |  info@altax.al

ALTAX – Albanian Center for Economic and Fiscal Policy

A research and development center for a more transparent and sustainable economic future

About ALTAX

ALTAX is a non-profit organization based in Albania, functioning as an independent research center for economic and fiscal policy. Its mission is to provide in-depth, unbiased, and reliable analysis on economic and fiscal developments in Albania, evaluating the impacts of political, cultural, ideological, economic, and historical factors.

ALTAX aims to contribute to the formulation of effective policies that serve not only Albania but also the wider Western Balkans region.

Focus and Activities

ALTAX collaborates with academics, fiscal experts, and international organizations to strengthen analytical and policymaking capacities in Albania and Kosovo.

Through detailed analyses of the economy, tax system, and macro/microeconomic indicators, ALTAX supports transparency, accountability, and improved public decision-making.

Areas of Engagement

- Market studies and sectoral trend analysis
 - State budget and statistical data analysis
 - Preparation of reports on economic and fiscal policies
 - Forecasting future developments for donors and stakeholders
 - Assessing the impact of fiscal and monetary policies on society and the economy
-

Services provided by ALTAX

- Preparation of analyses on economic and fiscal policies
 - Development of public policy models and sectoral expertise
 - Conducting studies and reports in collaboration with national and international partners
 - Evaluation of market trends and influencing factors
 - Data processing to inform policymaking
-

Contact

 For more information on ALTAX analyses and services, visit the official platform or contact the center directly. The ALTAX team is ready to provide customized solutions for specific questions or requests.

 www.altax.al |  info@altax.al

KUSHTET E PËRDORIMIT

Ky dokument është i mbrojtur me të drejta autori dhe ofrohet për përdorim jo-komercial, nën kushtet e mëposhtme të përcaktuara nga Qendra ALTAX:

1. Përdorim personal dhe profesional

Dokumenti mund të përdoret për qëllime studimore, kërkimore, profesionale dhe akademike. Çdo përdorim komercial pa autorizim të drejtpërdrejtë dhe të shkruar nga ALTAX është i ndaluar.

2. Detyrimi për citim të burimit

Në rast përdorimi për punime akademike, publikime kërkimore, dokumente zyrtare apo materiale të tjera analitike është i detyrueshëm citimi korrekt i burimit origjinal dhe autorëve përkatës.

3. Kufizime në përdorim

Ky material nuk mund të përdoret në forma që mund të shkaktojnë dëme ekonomike, reputacionale apo ligjore për individë apo institucione të tjera.

4. Opinione të autorëve

Të gjitha mendimet dhe përfundimet e shprehura janë ekskluzivisht të autorëve dhe nuk përfaqësojnë qëndrime zyrtare të Qendrës ALTAX. ALTAX nuk angazhohet në pozicionime politike institucionale, ndonëse analizat mund të përfshijnë vlerësime mbi politika publike.

5. Përgjegjësia e publikimit

Ky studim është botuar nën përgjegjësinë e ALTAX. Qëndrimet e paraqitura nuk pasqyrojnë domosdoshmërisht pikëpamjet e drejtimit apo partnerëve të Qendrës.

6. Riprodhimi dhe shpërndarja e përmbajtjes

Nëse teksti apo pjesë të tij shpërndahen, duhet të paraqiten në mënyrë të saktë dhe të plotë, duke i atribuar burimit origjinal autorësinë dhe përmbajtjen. Çdo përdorim i të dhënave dhe analizave duhet të shoqërohet me referencën përkatëse nga ky publikim.

7. Përgjegjësia e shpërndarësve të materialit

Përdoruesit që e shpërndajnë këtë dokument përmes çdo forme (fizike apo dixhitale) pranojnë të marrin masa të arsyeshme për të informuar përdoruesit përfundimtarë mbi këto kushte dhe të promovojnë zbatimin e tyre.

8. Ndalesa për shitje të paautorizuar

Çdo përpjekje për të shitur këtë dokument tërësisht ose pjesërisht, si produkt më vete apo i integruar, kërkon më parë një autorizim të shkruar nga Qendra ALTAX.

Fjalë kyçe: Integrimi europian, Shqipëria, procesi i anëtarësimit, sfidat gjeopolitike, reforma strukturore, marrëdhëniet me BE-në, rritje ekonomike, stabilitet fiskal, perspektiva rajonale

Kodi JEL: A10, D79, D91, E60

© Të gjitha të drejtat e rezervuara.

Përmbajtja e këtij studimi mund të përdoret lirisht për qëllime jo-fitimprurëse, me kusht që të citohet qartë Qendra ALTAX si burim origjinal.

TERMS OF USE

This document is protected by copyright and made available for non-commercial use under the following conditions set by the ALTAX Center:

1. **Personal and professional use**

This document may be used for educational, research, professional, and academic purposes. Any commercial use without prior written authorization from ALTAX is strictly prohibited.

2. **Source attribution requirement**

When used in academic work, research papers, or other publications, the original source and relevant authors must be properly cited.

3. **Usage restrictions**

The material must not be used in ways that may cause economic, reputational, or legal harm to individuals or institutions.

4. **Authorial opinions**

The views and conclusions expressed herein are solely those of the authors and do not represent institutional positions of the ALTAX Center. While the analyses may address public policies, ALTAX maintains neutrality and does not take official political stances.

5. **Publication responsibility**

This study has been published under the responsibility of ALTAX. The content does not necessarily reflect the views of its leadership or partners.

6. **Content reproduction and sharing**

If the content (text or any part) is shared or reproduced, it must be presented faithfully and attributed to the original source. Any use of data or analysis must include a proper reference to this publication.

7. **Distributor responsibility**

Users who distribute this document in any form (physical or digital) agree to take reasonable steps to inform end-users of these terms and promote compliance.

8. **Prohibition of unauthorized sale**

Any attempt to sell this content in whole or in part, whether as a standalone product or bundled, requires prior written approval from the ALTAX Center.

Keywords: European integration, Albania, accession process, geopolitical challenges, structural reforms, relations with the EU, economic growth, fiscal stability, regional perspective

JEL Code: A10, D79, D91, E60

© **All rights reserved.**

The content of this study may be used freely for non-commercial purposes, provided that ALTAX Center is clearly acknowledged as the source of information.

Konsiderata

(Shqip) Ky dokument është një reflektim i punës së përbashkët dhe përkushtimit të shumë profesionistëve që kanë kontribuar për ta bërë informacionin ekonomik dhe politik më të kuptueshëm dhe të aksesueshëm për publikun e gjerë.

ALTAX nëpërmjet këtij dedikimi falënderon autorët, si kontribuesit kryesorë. Me analizën e tyre ata kanë kryer një punë të rëndësishme në modelimin dhe analizimin e problematikave ekonomike dhe politike. Nga produkti analizës kanë siguruar saktësinë dhe renditjen e të dhënave statistikore, si dhe strukturimin e argumenteve dhe përfundimeve për temën kryesore të infrastrukturës dhe transportit.

Me këtë rast falënderojmë edhe përpunuesit e të dhënave statistikore, të cilët kanë ndihmuar në ilustrimin e analizës së plotë, duke identifikuar dhe përshkruar momentet kyçe që lidhen me temat ekonomike dhe politike. Falënderim i dedikuar është për ekspertët që bashkëpunojnë vullnetarisht me ALTAX. Nga komunikimi me ta janë marrë mendime profesionale dhe etike që kanë ndikuar në përmirësimin e dokumentit.

Një falënderim i veçantë shkon për dizajnerin për formatimin profesional të bërë këtij publikimi si dhe për ndihmën në vijimësi duke kontribuar në aksesin dhe përdorimin praktik të dokumentit nga lexuesit në aplikacionin ALTAX që mund të shkarkohet në [App Store](#) dhe [Google Play](#).

Kjo analizë është drejtuar dhe koordinuar nga Drejtoresh ekzekutive e ALTAX, e cila ka udhëhequr promovimin e vizionit të ALTAX përmes të gjitha produkteve të saj, duke përfshirë analiza, studime, publikime dhe platforma dixhitale që synojnë të informojnë dhe të angazhojnë publikun.

Faleminderit të gjithëve që mbështesin këtë mision dhe vijnë të kontribuojnë me njohuri dhe përvojën e tyre për një analizë të thelluar dhe të besueshme.

Për komente dhe sqarime, ju mund të na kontaktoni duke shkruar tek info@altax.com

Acknowledgement

(English) This document is a reflection of the joint work and dedication of many professionals who have contributed to making economic and political information more understandable and accessible to the general public.

ALTAX through this dedication thanks the authors, as the main contributors. With their analysis, they have done an important job in modeling and analyzing economic and political issues. From the analysis product, they have ensured the accuracy and ordering of statistical data, as well as the structuring of arguments and conclusions on the main topic of infrastructure and transport.

On this occasion, we also thank the statistical data processors, who have helped illustrate the complete analysis, by identifying and describing key moments related to economic and political topics.

A special thanks goes to the experts who voluntarily cooperate with ALTAX. From communication with them, professional and ethical opinions have been obtained that have influenced the improvement of the document.

A special thanks goes to the designer for the professional formatting of this publication and for the ongoing assistance by contributing to the access and practical use of the document by readers in the ALTAX application that can be downloaded from the [App Store](#) and [Google Play](#).

This analysis has been directed and coordinated by the Executive Director of ALTAX, who has led the promotion of ALTAX's vision through all its products, including analyses, studies, publications, and digital platforms aimed at informing and engaging the public.

Thanks to everyone who supports this mission and continues to contribute with their knowledge and experience for a thorough and reliable analysis.

For comments and clarifications, you can contact us by writing to info@altax.com

Follow & Connect with ALTAX and POLIFAKT

A relationship about the commonalities that unite us in everyday life.

 Stay connected across Platforms

 Platforma	 Përshkrimi	 Link
 ALTAX.AL	Lexoni dhe shkarkoni analiza unike dhe studime.	Visit ALTAX
 POLIFAKT.AL	Shihni sa premtime politike janë mbajtur.	Visit POLIFAKT
 ALTAX YouTube	Ndiqui video edukative dhe informuese.	ALTAX on YouTube
 Rrjetet Sociale	Komunikoni me ne në rrjete sociale.	Facebook · Twitter/X · LinkedIn
 Fiskalisti	Ti je në fokusin tonë. Krijojmë bashkë.	More Info
 App Store	Shkarkoni aplikacionin për celular.	Download on App Store
 Google Play	Merrni informacionet direkt në telefon.	Download on Google Play

What we do?

ALTAX – POLIFAKT

We publish and distribute information, ongoing analysis and studies – always keeping you in focus.

Why Follow Us?

Because together, we're building knowledge, transparency, and accountability.

"Our focus is on you, with unwavering dedication we collaborate to create real impact."

"Fokusi ynë është tek ju, me përkushtim të palëkundur bashkëpunojmë për të krijuar ndikim të vërtetë."



Bashkë për transparencë, dije dhe përfshirje

Ne jemi pranë jush – sepse ju jeni në qendër të misionit tonë!

 Së bashku krijojmë informacion të besueshëm, analiza të thelluara dhe mjetet për të kuptuar më mirë realitetin ekonomik dhe politik.

Çfarë bëjmë?

 Publikojmë analiza dhe studime me ndikim – ALTAX dhe POLIFAKT janë burime të pavarura për transparencë fiskale dhe politike.

 Vlerësojmë premtimet politike – te [POLIFAKT.AL](https://polifakt.al), kontrolloni sa janë mbajtur premtimet.

 Edukojmë përmes videove – ndiqni ALTAX në rrjete sociale dhe në [ALTAX.AL](https://altax.al) për përmbajtje të dobishme.

 Ju sjellim informacionin drejt në celular – me aplikacionin tonë në [App Store](https://appstore.com) dhe Google Play.

Bashkohuni me ne

- ◆ Për më shumë **transparencë publike**,
- ◆ Për më shumë **arsim fiskal dhe qytetar**,
- ◆ Për më shumë **besim tek e vërteta**.

 E ardhmja ndërtohet me informim. Bashkë krijojmë ndryshimin!

HYRJE

Integrimi europian i Shqipërisë gjendet në një **kryqëzim kritik në vitin 2025**, një moment ku dinamika e brendshme e reformave kombëtare ndërthuret me një **Europë që po rimodelohet** nga tensionet gjeopolitike, transformimet energjetike dhe sfidat tregtare globale. Ndërsa Bashkimi European po përballët me rritjen e fragmentimit ekonomik, zhvendosjen e boshtit industrial drejt teknologjisë së gjelbër dhe pasojat e luftës tregtare transatlantike, vendet aspirante si Shqipëria po testojnë **elasticitetin e tyre institucional, fiskal dhe ekonomik** në raport me standardet e reja të Unionit.

Në këtë kontekst, **procesi i integrimit nuk është më vetëm një projekt politik**, por një **transformim i thellë strukturor**, që ndikon në mënyrën se si funksionon ekonomia, qeverisja dhe sistemi social i vendit. Shqipëria, pas më shumë se tri dekadash tranzicioni, po hyn në një fazë ku përafrimi me BE-në nuk matet vetëm me ligje të miratuara, por me **cilësinë e zbatimit, efikasitetin e institucioneve publike dhe qëndrueshmërinë e modelit ekonomik** që do ta mbështesë integrimin afatgjatë.

Bashkimi European vetë po përjeton një **periudhë transformimi paradigmatic**. Lufta në Ukrainë, tensionet tregtare SHBA-BE, tranzicioni drejt ekonomisë së gjelbër dhe valët e reja të inflacionit energjetik kanë vënë në provë kohezionin dhe mekanizmat fiskalë të Unionit. Për një vend si Shqipëria, që ka më shumë se 70% të eksporteve dhe gjysmën e importeve të lidhura me BE-në, çdo ndryshim në ekuilibrin ekonomik europian **reflektohet menjëherë në treguesit kombëtarë**, nga çmimet e konsumit te kursi i këmbimit dhe stabiliteti buxhetor.

Në këtë realitet, **mësimet nga përvoja europiane** ndaj krizave të fundit, qoftë pandemia, energjia, apo inflacioni ofrojnë **paralele të vlefshme për Shqipërinë**. Ato tregojnë se suksesi në integrim nuk qëndron vetëm në harmonizimin formal të legjislationit, por në **aftësinë për t'u përshtatur me tronditjet e jashtme pa cenuar stabilitetin e brendshëm**. Kjo kërkon një model zhvillimi të bazuar në **diversifikim ekonomik, stabilitet fiskal dhe qeverisje të përgjegjshme**, tre shtylla që përcaktojnë jo vetëm ritmin, por edhe cilësinë e rrugëtimit europian.

Shqipëria ndodhet pra **në pragun midis aspiratës dhe provës**, midis vizionit politik të anëtarësimit dhe kapacitetit real për të përballuar kostot strukturore që sjell ai proces. Ndërkohë që BE-ja po përgatitet për një **zgjerim të ri strategjik deri në vitin 2030**, vendi duhet të demonstrojë se mund të **balancojë përfitimet e integrimit me sfidat e qëndrueshmërisë ekonomike**.

Ky studim synon të analizojë me realizëm dhe thellësi **ndikimet fiskale, makroekonomike dhe gjeopolitike** që shoqërojnë procesin e integrimit europian të Shqipërisë, duke nxjerrë në pah rreziqet, mundësitë dhe kushtet që duhet të plotësohen për ta kthyer këtë proces nga një objektiv politik në një **strategji zhvillimi kombëtar**.

Qëllimi dhe Synimet

Qëllimi dhe synimet e këtij studimi janë të hulumtojnë rrugëtimin e Shqipërisë drejt integritit evropian gjatë vitit 2025, duke u fokusuar në proceset, sfidat, dhe arritjet kryesore brenda këtij perspektive kohore.

Në mënyrë specifike, studimi synon të analizojë progresin dhe objektivat strategjike të Shqipërisë për anëtarësimin në BE, duke përfshirë integrimin e saj në strukturat europozitive, rritjen e konkurrueshmërisë ekonomike, dhe forcohem e institucioneve shtetërore të së drejtës dhe qeverisjes së mirë.

Gjithashtu, objektivi është të vlerësojë ndikimin e sfidave gjeopolitike rajonale dhe globale, si dhe ndikimin e politikave të BE-së në procesin e adaptimit dhe reformave shqiptare.

Përmes këtij studimi synohet gjithashtu të identifikohen mundësitë për përshpejtimin e procesit të integritit, duke u dhënë udhëzime dhe rekomandime për përmirësimin e strategjive të brendshme dhe përfshirjen e vendit në proceset evropiane.

Duke analizuar shumë aspekte të këtij rrugëtimi, studimi synon të kontribuojë në koordinimin e politikave kombëtare dhe ndërkombëtare që janë të nevojshme për realizimin e të drejtave përballë standardeve dhe kërkesave të Bashkimit Evropian, dhe për sigurinë e perspektivës evropiane të Shqipërisë.

PËRMBLEDHJE

Integrimi europian i Shqipërisë gjendet në një kryqëzim kritik historik në vitin 2025, një moment që përcakton jo vetëm fatin gjeopolitik të vendit por edhe aftësinë e tij për të siguruar qëndrueshmëri ekonomike dhe stabilitet afatgjatë. Në këtë kohë vendimtare, Bashkimi European vetë përballlet me një periudhë të re tensionesh gjeopolitike dhe tregtare që po rimodelojnë thellësisht peizazhin ekonomik dhe sigurinë e kontinentit. Mësimet nga përvoja europiane ndaj sfidave aktuale, lufta në Ukrainë, konflikti tregtar me Shtetet e Bashkuara, kriza energjetike dhe përhapja e populizmit ofrojnë paralele thelbësore dhe mësim të vlefshme për rrugëtimin e Shqipërisë drejt anëtarësimit në BE.

Viti 2025 shënon një pikë kthese të pazakontë për Shqipërinë në procesin e saj të integrimit europian. Pas dekadash pritjesh dhe reformash të ndërprera, Tirana ka arritur të hapë katër nga gjashtë klasteret negociuese në vetëm 11 muaj, një rekord historik që asnjë vend tjetër kandidat nuk e ka arritur më parë. Në tetor 2024, Shqipëria hapi Klasterin 1 mbi Themelet, duke u ndarë nga procesi i përbashkët me Maqedoninë e Veriut që kishte vonuar bisedimet për vite me radhë. Kjo shkëputje e proceseve u pasua nga hapja e Klasterit 6 mbi Marrëdhëniet e Jashtme në dhjetor 2024, Klasterit 2 mbi Tregun e Brendshëm në prill 2025, Klasterit 3 mbi Konkurrencën dhe Rritjen Gjithëpërfshirëse në maj 2025, dhe më së fundmi Klasterit 4 mbi Agjendën e Gjelbër dhe Lidhshmërinë e Qëndrueshme në shtator 2025.

Ritmi i përshpejtuar i negociatave ka bërë që objektivi i Kryeministrit Edi Rama për të mbyllur të gjitha kapitujt negociues deri në fund të vitit 2027 dhe për t'u bërë gati për anëtarësim deri në 2030 të mos duket më si një aspiratë joreale. Presidenti francez Emmanuel Macron është shprehur hapur se brenda dy vitesh Shqipëria mund të anëtarësohet në BE, duke nënvizuar suksesin e reformave të realizuara nën mandatin e qartë të qeverisë aktuale. Komisarja për Zgjerim Marta Kos ka vlerësuar se "shpejtësia e Shqipërisë është mbresëlënëse" dhe ka konfirmuar se hapja e klasterit të fundit të mbetur (Klasteri 5 mbi Bujqësinë dhe Kohezionin) pritet të ndodhë së shpejti.

Megjithatë, ky progres vjen në një kohë kur Bashkimi European vetë po kalon nëpër një transformim të thellë të provokuar nga kriza të shumëfishta që kërcënojnë themelet e projektit europian. Agresioni rus kundër Ukrainës, që vazhdon të jetë konflikti më i madh ushtarak në Europë që nga Lufta e Dytë Botërore, ka shkaktuar vdekje të pafundme njerëzish, shkatërrim të gjerë infrastrukture dhe ka detyruar miliona ukrainas të zhvendosen. Kërcënimi rus nuk kufizohet vetëm në Ukrainë, sulmet kibernetike të sofistikuara, ndërhyrjet politike, sabotazhet ndaj infrastrukturës kritike dhe përdorimi strategjik i energjisë si armë demonstrojnë një kërcënim shumëdimensional që synon të destabilizojë Europën në tërësi.

Nga ana tjetër, marrëdhëniet transatlantike po kalojnë nëpër një periudhë të pasigurisë së thellë. Qasja e administratës Trump ndaj Ukrainës dhe pyetjet e ngritura rreth angazhimit afatgjatë amerikan për sigurinë europiane kanë shtytur liderët europianë të marrin përgjegjësi më të madhe për mbrojtjen e kontinentit. Iniciativa "ReArm Europe" me një zotim prej 800 miliardë eurosh për shpenzime mbrojtëse përfaqëson një ndryshim fundamental drejt vetë-mbështetjes dhe autonomisë strategjike. Vendet si Mbretëria e Bashkuar, Franca dhe Gjermania po rrisin ndjeshëm mbështetjen ekonomike për Ukrainën dhe po ndërtojnë një "koalicion të gatshëm" që mund të mbështesë Kievin pavarësisht nga angazhimi amerikan.

Në fushën ekonomike, tensionet tregtare midis Shteteve të Bashkuara dhe Kinës, si dhe tarifave e reja amerikane ndaj produkteve evropiane, kanë krijuar një klimë të pasigurisë që dëmton besimin e bizneseve dhe konsumatorit. Tarifat amerikane që shkojnë deri në 15% për produktet e përgjithshme evropiane dhe 50% për metalin kanë frenuar rritjen e eksporteve evropiane, me Gjermaninë, motorin ekonomik të BE-së, si më të prekurin. Eksportet gjermane në SHBA ranë në nivelin më të ulët në katër vjet, duke shënuar një rënie prej 4% në gusht 2025, ndërsa importet nga Amerika u ulën për 10%.

Njëkohësisht, BE-ja përballet me presione nga importet kineze që po ridrejtohen nga tregu amerikan drejt Europës si rezultat i luftës tregtare SHBA-Kinë. Ekspertët e Bankës Qendrore Evropiane paralajmërojnë se rritja e importeve kineze mund të sjellë presione deflacioniste në ekonominë e eurozonës, duke e bërë më të vështirë arritjen e objektivit të inflacionit prej 2%. Kjo situatë krijon një paradoks: ndërsa tarifave amerikane rrisin kostot për konsumatorët evropianë, rrjedha e mallrave kineze në treg mund të ulë çmimet në disa sektorë, duke krijuar një mjedis kompleks ekonomik për politikëbërësit.

Kriza energjetike vazhdon të mbetet një cen në krah për Europën. Edhe pse kontinenti ka arritur të reduktojë varësinë nga furnizimet ruse, infrastruktura energjetike evropiane përballet me kërcënime të vazhdueshme fizike dhe kibernetike, ndërsa varësitë e reja nga mineralet kritike sjellin cenueshmëri të reja gjeopolitike. Çmimet e energjisë mbeten të larta, duke vënë presion mbi industrinë evropiane dhe duke rrezikuar që ekonomia e BE-së të hyjë në stagflacion, një kombinim i rritjes së dobët ekonomike me inflacion të lartë.

Për Shqipërinë, këto zhvillime evropiane nuk janë thjesht lajme të largëta diplomatike, por ato janë realitete që prekin direkt ekonominë, sigurinë dhe perspektivat e saj të ardhshme. Me më shumë se 70% të tregtisë së jashtme të lidhur me Bashkimin Evropian, çdo tronditje që prek bllokun evropian gjen jehonë të menjëhershme në treguesit makroekonomikë shqiptarë. Varësia e thellë nga remitencat e emigrantëve që punojnë në eurozonë, ekspozimi ndaj çmimeve të energjisë evropiane dhe integrimi në zinxhirët e furnizimit të kontinentit bëjnë që Shqipëria të jetë veçanërisht e cenueshme ndaj këtyre valëve ekonomike.

Në këtë kontekst të pasigurt gjeopolitik dhe ekonomik, rrugëtimi i Shqipërisë drejt anëtarësimit në BE përfaqëson jo vetëm një aspiratë politike, por një domosdoshmëri strategjike për të siguruar stabilitet, rritje ekonomike dhe sigurinë kombëtare.

Harmonizimi i këtyre faktorëve përbën parakushtin thelbësor që integrimi evropian të evoluojë nga një objektiv politik në një realitet strukturor, duke krijuar bazën për rritje të qëndrueshme, siguri kombëtare dhe mirëqenie afatgjatë për qytetarët shqiptarë.

1. Ekspozimi i Shqipërisë ndaj krizave europiane

Shqipëria, si një ekonomi e vogël, e hapur dhe me bazë të kufizuar prodhuese, është shumë e ndjeshme ndaj zhvillimeve ekonomike të Bashkimit European, partnerit të saj kryesor tregtar dhe financiar.

Me rreth 71% të eksporteve dhe 51% të importeve të lidhura drejtpërdrejt me vendet e BE-së, çdo luhajtje ekonomike, financiare apo politike në tregun european reflektohet menjëherë në treguesit makroekonomikë shqiptarë, nga kursi i këmbimit dhe inflacioni, deri te punësimi dhe bilanci tregtar.

Kjo varësi strukturore është përforcuar gjatë dekadës së fundit përmes integritit të zinxhirëve të furnizimit dhe prodhimit me kompanitë europiane, veçanërisht në sektorët e tekstileve, përpunimit ushqimor dhe ndërtimit.

Megjithatë, ky integrim ekonomik ka ndodhur pa instrumentet mbrojtëse që kanë shtetet anëtare të BE-së, si akses në fondet e stabilitetit, në politikat e përbashkëta të subvencioneve, apo në mbështetjen monetare të Bankës Qendrore Europiane.

Kjo situatë e vendos Shqipërinë në një pozitë asimetrike: ajo është e integruar në rreziqet, por jo në garancitë e sistemit european. Ndaj, në momentet kur BE-ja përballet me tronditje, si ngadalësimi i ekonomisë gjermane, luhajtjet e euros, apo politikat proteksioniste amerikane ndaj eksporteve europiane me tarifa që arrijnë deri në 15% për disa produkte, efektet zinxhir ndikojnë menjëherë edhe në tregun shqiptar.

Në praktikë, kjo do të thotë që rënia e kërkesës europiane për mallra dhe shërbime përkthehet në ulje të eksporteve shqiptare, reduktim të porosive në industrinë fason, rënien e remitancave dhe tkurrje të flukseve turistike nga vendet e BE-së.

Njëkohësisht, rritja e çmimeve të importeve europiane ndikon drejtpërdrejt në koston e jetesës së familjeve shqiptare, duke e bërë inflacionin më të ndjeshëm ndaj tronditjeve të jashtme.

Në këtë kuadër, ekspozimi i dyfishtë i Shqipërisë, ekonomikisht i varur nga BE-ja, por institucionalisht jashtë saj krijon një sfidë strategjike për politikëbërjen ekonomike kombëtare. Shqipëria përballet me krizat europiane si vend i brendshëm në treg, por i jashtëm në përfitime.

Kjo mospërputhje kërkon forcimin e politikave të stabilitetit makroekonomik brenda vendit, rritje të rezervave valutore, si dhe diversifikim të tregjeve dhe partnerëve ekonomikë, për të reduktuar varësinë nga një rajon i vetëm.

Nëse ky ekspozim nuk menaxhohet në mënyrë strategjike, çdo krizë e ardhshme europiane, qoftë ajo fiskale, energjetike apo tregtare do të ketë pasoja të menjëhershme në rritjen ekonomike të Shqipërisë, në fuqinë blerëse të familjeve dhe në qëndrueshmërinë fiskale të qeverisë.

2. Dëmtimet nga lufta tregtare SHBA–BE dhe më gjerë

Përplasjet tregtare mes Shteteve të Bashkuara dhe Bashkimit Europian, të cilat janë thelluar në vitet e fundit përmes tarifave ndëshkuese, subvencioneve industriale dhe rivaliteteve teknologjike, kanë prodhuar një efekt zinxhir në tregjet globale, efekt që tashmë ndjehet edhe në ekonomi të vogla e të hapura si ajo shqiptare.

Rritja e çmimeve të produkteve të importuara nga Europa, që variojnë nga materialet e ndërtimit, komponentët elektronikë, deri te makineritë dhe mallrat gjysmë të përpunuara, ka krijuar një presion të dyfishtë mbi bizneset shqiptare.

Nga njëra anë, kosto më të larta të inputeve të prodhimit dhe nga ana tjetër, kufizim të konkurrueshmërisë së produkteve shqiptare në tregjet e eksportit. Kjo ndodh në një moment kur ndërmarrjet shqiptare tashmë përballen me çmime të paqëndrueshme të energjisë, me mungesë të fuqisë punëtore të kualifikuar dhe me kosto logjistike të larta për transportin ndërkombëtar. Në vitin 2024, importet e Shqipërisë arritën rreth 9 miliardë euro, ndërsa eksportet afërsisht 3.8 miliardë euro me mbi 70% të këtij tregu të lidhur direkt me vendet e BE-së. Në këtë kuadër, çdo turbulencë tregtare mes SHBA-së dhe BE-së përkthehet në rritje të çmimeve për konsumatorin shqiptar dhe në rritje të presionit mbi buxhetin e familjeve.

Inflacioni i importuar, veçanërisht për materialet ndërtimore, automjetet dhe pajisjet teknologjike ka filluar të ndikojë jo vetëm në koston e jetesës, por edhe në aftësinë e bizneseve për të investuar dhe për të ruajtur marzhet e fitimit.

Në një analizë më të thellë, lufta tregtare SHBA–BE ka zbuluar edhe varësinë strukturore të ekonomisë shqiptare nga zinxhirët e furnizimit europian. Shqipëria, si vend kandidat për BE, është integruar gradualisht në tregun europian përmes marrëdhënieve tregtare, teknologjike dhe të investimeve.

Kjo e bën ekonominë shqiptare më të ekspozuar ndaj çdo luhatjeje të politikave industriale europiane që ndikohet nga politikat e jashtme të SHBA-së, nga subvencionet për energjinë e gjelbër, deri te kufizimet ndaj produkteve kineze dhe tarifave për çelikun e aluminiut.

Për më tepër, për shkak të strukturës së saj importuese, Shqipëria është marrës i çmimeve dhe jo përcaktues në tregun ndërkombëtar. Kjo do të thotë se çdo rritje kostoje në zinxhirin europian transmetohet direkt në tregun vendas pa mundësi kompensimi përmes prodhimit lokal. Në këtë mënyrë, lufta tregtare midis dy ekonomive më të mëdha të Perëndimit ka shndërruar Shqipërinë në një “përcjellëse pasive të tronditjeve tregtare”, me pasoja që mund të zgjasin në kohë dhe të frenojnë procesin e modernizimit industrial.

Nëse kjo dinamikë vazhdon, një nga efektet afatmesme do të jetë shtimi i presioneve për deindustrializim të lehtë, sidomos në sektorët që mbështeten tek importet e lëndëve të para dhe komponentëve europianë. Për qeverinë shqiptare dhe politikëbërësit ekonomikë, kjo situatë kërkon një qasje më të kujdesshme në diversifikimin e partnerëve tregtarë, në krijimin e rezervave strategjike të inputeve, si dhe në stimuj për prodhim vendas që redukton varësinë nga tregjet e jashtme në rast krizash të tilla.

Një efekt zinxhir që përfshin Kinën, Rusinë dhe vendet në zhvillim

Përplasjet tregtare mes Shteteve të Bashkuara dhe Bashkimit Europian, të cilat janë thelluar në vitet e fundit përmes tarifave ndëshkuese, subvencioneve industriale dhe rivaliteteve teknologjike kanë prodhuar një efekt zinxhir në tregjet globale, efekt që tashmë ndjehet edhe në ekonomi të vogla e të hapura si ajo shqiptare.

Por dinamika e kësaj lufte tregtare ka marrë një dimension më kompleks me përfshirjen e Kinës si protagonist kryesor, Rusisë si faktor destabilizues gjeopolitik, dhe vendeve në zhvillim si marrës pasivë të tronditjeve ekonomike globale.

Rritja e çmimeve të produkteve të importuara nga Europa, që variojnë nga materialet e ndërtimit, komponentët elektronikë, deri te makineritë dhe mallrat gjysmë të përpunuara ka krijuar një presion të dyfishtë mbi bizneset shqiptare.

Nga njëra anë, kosto më të larta të inputeve të prodhimit dhe nga ana tjetër, kufizim të konkurrueshmërisë së produkteve shqiptare në tregjet e eksportit. Kjo ndodh në një moment kur ndërmarrjet shqiptare tashmë përballen me çmime të paqëndrueshme të energjisë, me mungesë të fuqisë punëtore të kualifikuar dhe me kosto logjistike të larta për transportin ndërkombëtar.

Në vitin 2024, importet e Shqipërisë arritën rreth 9 miliardë euro, ndërsa eksportet afërsisht 3.8 miliardë euro, me mbi 70% të këtij tregu të lidhur direkt me vendet e BE-së. Në këtë kuadër, çdo turbulencë tregtare mes SHBA-së dhe BE-së përkthehet në rritje të çmimeve për konsumatorin shqiptar dhe në rritje të presionit mbi buxhetin e familjeve. Inflacioni i importuar, veçanërisht për materialet ndërtimore, automjetet dhe pajisjet teknologjike ka filluar të ndikojë jo vetëm në koston e jetesës, por edhe në aftësinë e bizneseve për të investuar dhe për të ruajtur marzhet e fitimit.

Roli i Kinës dhe ridrejtimi tregtar dhe presioni deflacionist

Dimensioni kinez i luftës tregtare amerikano-evropiane ka shtuar një shtresë kompleksiteti që e ndikon drejtpërdrejt Shqipërinë. Tarifat amerikane ndaj produkteve kineze, që arrijnë deri në 130% për disa kategori mallrash kanë detyruar Kinën të ridrejtojë një pjesë të konsiderueshme të eksporteve të saj nga tregu amerikan drejt Europës. Sipas Bankës Qendrore Europiane, tarifat amerikane të vitit 2018 çuan në një rritje statistikisht të rëndësishme prej 2-3% të importeve të eurozonës nga Kina, ndërsa të dhënat e vitit 2025 tregojnë se importet e BE-së të tekstileve dhe veshjeve kineze u rritën me 20% në gjysmën e parë të vitit krahasuar me vitin e kaluar.

Ky ridrejtim tregtar krijon dy presione të kundërta për ekonominë shqiptare. Nga njëra anë, rrjedha më e madhe e mallrave kineze në tregun evropian po ulin çmimet në disa sektorë, veçanërisht në tekstil, elektronikë dhe produkte të konsumit duke krijuar presion deflacionist që e bën më të vështirë arritjen e objektivit të inflacionit prej 2% të Bankës Qendrore Europiane. Kjo dinamikë mund të duket si lajm i mirë për konsumatorët, por ajo vjen me kosto: bizneset shqiptare që prodhojnë në sektorë të ngjashëm gjenden përballë konkurrencës kineze që shitet me çmime agresivisht të ulëta.

Nga ana tjetër, produktet kineze që importohen në Shqipëri përmes tregut evropian apo drejtpërdrejt përmes platformave online si Shein dhe Temu po krijojnë presion mbi prodhuesit vendas. Presidenti i Euratex, shoqatës evropiane të tekstilit, ka deklaruar se "firmat kineze, që nuk mund të shesin më në Shtetet e Bashkuara, po adoptojnë një qasje shumë agresive për të depërtuar

në tregun europian". Kjo depërtim ndikon edhe tregun shqiptar, ku industria e lehtë dhe e tekstilit edhe pse e vogël mbetet një punëdhënëse i rëndësishëm veçanërisht për fuqinë punëtore femërore.

Impakti rus dhe ndikimi në Ballkanin Perëndimor

Ndërkohë që Shqipëria ka marrëdhënie tregtare minimale me Rusinë me eksporte vjetore prej vetëm afërsisht 1 milion euro dhe importe që përfaqësojnë më pak se 1% të totalit të importeve, ndikimi i sanksioneve kundër Rusisë dhe pasojat e luftës në Ukrainë ndjehen indirekt përmes kanalëve europianë. Shqipëria, si vend kandidat për BE, ka harmonizuar plotësisht politikën e saj të jashtme me sanksionet e BE-së kundër Rusisë që nga marsi 2022, duke u përfshirë në platformën QUAD së bashku me Kosovën, Malin e Zi dhe Maqedoninë e Veriut që synon 100% harmonizim me Politikën e Përbashkët të Jashtme dhe të Sigurisë.

Sanksionet ndaj Rusisë kanë krijuar tre kanale të ndikimit në Ballkanin Perëndimor dhe Shqipërinë në veçanti:

Kanali i parë janë çmimet e energjisë dhe ushqimit. Edhe pse Shqipëria nuk importon gaz nga Rusia, çmimet e larta të energjisë në tregun europian, të shkaktuara nga ndërprerja e furnizimeve ruse transmetohen në ekonominë shqiptare përmes çmimeve të mallrave të importuara dhe kostove të energjisë elektrike që lidhen me tregjet rajonale. Rusia dhe Ukraina së bashku përbëjnë mbi 25% të eksporteve botërore të grurit, dhe ndërprerja e këtyre furnizimeve ka rritur çmimet e ushqimeve bazë edhe në Shqipëri.

Kanali i dytë është reduktimi i kërkesës europiane. Ekonomitë e Europës Perëndimore, partnerë kryesorë tregtarë të Shqipërisë kanë parë ngadalësim të rritjes ekonomike si pasojë e krizës energjetike, inflacionit të lartë dhe pasigurisë gjeopolitike. Kjo ka ulur kërkesën për eksportet shqiptare, veçanërisht në sektorë si tekstili, këpucët dhe materialet e ndërtimit që janë të ndjeshëm ndaj ciklit ekonomik.

Kanali i tretë është ndërprerja e zinxhirëve të furnizimit. Rusia dhe Ukraina prodhojnë metale të rralla që përdoren në procesorë për industrinë e automobilave dhe kompjuterëve. Ndërprerja e këtyre furnizimeve ka krijuar vonesa dhe kosto shtesë për industritë europiane që Shqipëria furnizon me komponente dhe shërbime.

Vendet në zhvillim, si viktime kolaterale të luftës tregtare

Efekti cascadë i luftës tregtare SHBA-Kinë-BE ka goditur veçanërisht vendet në zhvillim, duke përfshirë Shqipërinë dhe fqinjët e saj ballkanikë. Studime të Bankës Botërore tregojnë se edhe pse disa vende si Vietnami, Malajzia dhe Etiopia kanë përfituar nga ridrejtimi i investimeve të huaja direkte dhe i zinxhirëve të prodhimit që po largohen nga Kina, shumica e vendeve në zhvillim kanë pësuar efekte negative.

Për vendet e Ballkanit Perëndimor, përfshirë Shqipërinë, këto efekte manifestohen si më poshtë:

Rritje e pasigurisë së investimeve. Klima globale e pasigurisë tregtare ka bërë që investitorët e huaj të jenë më të kujdesshëm në vendosjen e kapitalit në tregje të vogla dhe të paqëndrueshme. Edhe pse Shqipëria ka parë rritje të investimeve në disa sektorë, veçanërisht në energjinë e rinovueshme dhe turizëm projekte më të mëdha industriale janë vonuar për shkak të pasigurisë globale.

Inflacion i importuar dhe kosto më të larta të importeve. Vendet në zhvillim si Shqipëria, që janë importues neto të mallrave industriale, po vuajnë nga inflacioni i importuar që vjen si nga tarifat amerikane ndaj produkteve europiane ashtu edhe nga ridrejtimi i produkteve kineze që bëhet me çmime të ulëta por që destabilizon prodhimin vendor. Kjo krijon një paradoks: konsumatorët përfitojnë afatshkurtër nga çmimet më të ulëta, por bizneset vendase humbasin konkurrencën dhe mbyllin operacionet, duke çuar në humbje vendesh pune.

Dobësim i konkurrencës eksportuese. Shqipëria dhe vendet e tjera të vogla në zhvillim nuk kanë shkallën apo fuqinë politike për të negociuar marrëveshje tregtare të favorshme në këtë klimë të polarizuar. Kur SHBA dhe BE luftojnë me tarifa dhe Kina përgjigjet me ridrejtim të eksporteve, vendet e vogla humbasin hapësirën e tyre të vogël në treg.

Presion mbi borxhin publik dhe hapësirën fiskale. Vendet në zhvillim, duke përfshirë Shqipërinë, po përballen me kosto më të larta të financimit të borxhit publik për shkak të rritjes së normave të interesit globale dhe të rrezikut gjeopolitik. Kjo kufizon aftësinë e qeverive për të investuar në infrastrukturë, arsim dhe shëndetësi, investime që janë thelbësore për rritjen afatgjatë.

Shqipëria si "përcjellëse pasive e tronditjeve tregtare"

